



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P-157
Prishtinë, 13 mars 2014

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 13, 14 DHE 19 MARS 2014**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmuan nënkryetarët Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së parë plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Halit Krasniqi, Hykmete Bajrami, Visar Ymeri, Time Kadrijaj, Suzan Novoberdaliu, Rasim Demiri, Arsim Bajrami, Ismet Beqiri, Faton Topalli, Aurora Bakalli, Jeton Svirca, Jakup Krasniqi, Ardian Gjini, Adem Grabovci, Gëzim Kelmendi, Naser Osmani, Alma Lama, Shaip Muja, Ahmet Isufi, kryeministri Hashim Thaçi dhe ministri Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Xhavit Uka parashtroi pyetje për ministrin Fehmi Mujota në lidhje me procedurat për ndërtimin e rrugës Piranë - Mamushë.

Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhavit Uka.

Deputeti Nijazi Idrizi parashtroi pyetje për ministrin Fehmi Mujota në lidhje me procedurat për fillimin e ndërtimit të rrugës Gjilan – Prishtinë.

Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetit Nijazi Idrizi.

Deputetja Time Kadrijaj parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me anulimin e konkursit për drejtorë të klinikave në QKUK dhe kur pritet të shpallet përsëri.
Ministri Ferid Agani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Time Kadrijaj parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me renditjen e personave që kanë aplikuar jashtë institucioneve shëndetësore për shërim dhe sa është kohëzgjatja e pritjes?
Ministri Ferid Agani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me masat e ndërmarra nga Ministria e Financave për të kontrolluar fondin për zhvillim të veriut, për shkak të rrezikut të lartë të keqpërdorimeve që ekziston në veri të vendit.
Ministri Besim Beqaj nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me kriteret për ndërrimin e 50 % të njësive të trafikut rajonal në Mitrovicë.
Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputeti Visar Ymeri parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me veprimet apo mosveprimet e Inspektoratit të Punës për të siguruar nëse janë shkelur të drejtat e 70 punëtorëve të larguar nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës” Adem Jashari” të cilat të drejta janë të garantuara me Ligjin e Punës në Kosovë.
Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetit Visar Ymeri.

Deputeti Glauk Konjufca parashtroi pyetje për zv/kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me masat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës lidhur me deklaratat e Qeverisë së Serbisë për organizimin e zgjedhjeve serbe edhe në territorin e Kosovës.
Zv/kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

* * *

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe provimin e Maturës Shtetërore,*
4. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit,*
6. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës,*
7. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,*
8. *Shqyrtimi i Planit Hapësinor “Monumenti i natyrës me rëndësi të veçantë - Ujëvarat e Mirushës”,*
9. *Shqyrtimi i Planit Hapësinor “Zona e mbrojtur me interes të veçantë - Beteja e Koshares”,*
10. *Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për hartimin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”,*

11. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare,
12. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit,
13. Zgjedhja e Avokatit të Popullit,
14. Zgjedhja e një anëtari joekzekutiv në Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
15. Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media dhe
16. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie.

* * *

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe provimin e Maturës Shtetërore

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për provimin përfundimtar dhe provimin e Maturës Shtetërore.

Ministri Ramë Buja tha se ky projektligj rregullon mënyrën e organizimit, përmbajtjen, kushtet, kriteret dhe procedurat e provimit përfundimtar dhe provimit të Maturës Shtetërore.

Ndër sfidat kryesore të Qeverisë së Kosovës, është krijimi i një sistemi të mirëfilltë ligjor dhe efikas, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare në fushën përkatëse.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Ramë Buja është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Ramë Vataj - në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media; Xhevahire Izmaku - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Sadri Ferati - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Afrim Kasolli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Jeton Svirca - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Agim Kuleta, Kymete Bajraktari dhe ministri Ramë Buja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 66,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si Komision FunkSIONAL dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kryeministri Hashim Thaçi tha se ky projektligj përcakton kategorizimin e pjesëmarrësve në Luftën Çlirimtare të Kosovës, pajisjen me dokumente përkatëse të veteranëve sipas këtij kategorizimi, përcaktimin e të drejtave në benificione të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe anëtarëve të ngushtë të familjeve të tyre, të cilët, me sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar, ishin faktorë vendimtarë për lirinë dhe pavarësinë e popullit të Kosovës.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z Hashim Thaçi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fikrim Damka - në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale; Salihe Mustafa - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Anton Quni - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Valbona Dibra, Sabri Hamiti, Rexhep Selimi, Teuta Haxhiu, Gëzim Kelmendi, Hasime Krasniqi, Haki Demolli, Jakup Krasniqi, Ahmet Isufi, Vesna Mikiq, Sala Berisha-Shala, Alma Lama, Bekim Haxhiu, Hatim Baxhaku, Visar Ymeri, Halit Krasniqi, Anton Quni, Shaip Muja, Xhavit Haliti, Blerta Deliu-Kodra, Xhevdet Neziraj, Armend Zemaj, Nait Hasani, Myzejene Selmani, Goran Marinković, Muhamet Mustafa, Ganimete Musliu, Xhafer Tahiri, Salih Morina, Xhevahire Izmaku, Arben Gashi, Adem Grabovci dhe ministri Agim Çeku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 71,
Kundër ----- 3,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

* * *

* * *

Në vazhdim kryesuesi, konstatoi se Kuvendi përfundoi punimet për ditën e sotme, ndërsa vazhdimi i punimeve të kësaj mbledhje plenare do të bëhet më 14 mars 2014, në orën 10:00.

* * *

Kryesuesi i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 18:45 minuta.

* * *

14 mars 2014, ora 10:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 13 mars 2014

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari i Kuvendit Xhavit Haliti.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 13 mars 2014.

Ai procedoi me pikat, si në vijim:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Ministri Bajram Rexhepi tha se ky projektligj përcakton veprën penale të bashkimit apo pjesëmarrjes në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolicore, në organizimet grupore apo individuale, në çfarëdo forme të konflikteve të armatosura jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Bajram Rexhepi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Ahmet Isufi - në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së; Fatmir Xhelili - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Anton Quni - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ahmet Isufi në emër të Grupit

Parlamentar të AAK-së; Rasim Demiri - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Haki Demolli, Rexhep Selimi, Hydajet Hyseni, Ardian Gjini, Alma Lama, Zenun Pajaziti, Amir Ahmeti, Armend Zemaj, Bekim Haxhiu, Vjollca Krasniqi, Goran Marinković, Arsim Bajrami, Muhamet Mustafa, Albin Kurti, Skender Hyseni, Gëzim Kelmendi, Halit Krasniqi, Faton Topalli, Jeton Svirca dhe ministri Bajram Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 48,
Kundër ----- 10,
Abstenime ----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

Deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, paraqiti para deputetëve Raportin me rekomandime.

Kryesuesi pastaj hodhi në votim amendamentet, veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, dhe 21.

Pastaj, kryetari hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----61,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin nr. 04/L-232 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, paraqiti para deputetëve Raportin me rekomandime.

Deputeti Nijazi Idrizi diskutoi dhe e tërhoqi nga propozimi amendamentin nr 2. në këtë projektligj.

Kryesuesi më pas hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente 1 dhe 3.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 54,
Kundër ----- 7,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin nr. 04/L-246 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

8. Shqyrtimi i Planit Hapësinor “Monumenti i natyrës me rëndësi të veçantë - Ujëvarat e Mirushës”

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Planin Hapësinor “Monumenti i natyrës me rëndësi të veçantë - Ujëvarat e Mirushës”.

Ministri Dardan Gashi tha se Monumenti i natyrës me rëndësi të veçantë - Ujëvarat e Mirushës” është dokument kryesor i zhvillimit hapësinor të zonës, në të cilin janë trajtuar me shumë kujdes të gjitha çështjet që ndërlidhen me mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e vlerave që ka kjo zonë në përgjithësi.

Dokumenti është hartuar nga Instituti për Planifikim Hapësinor dhe ndihmë të konsiderueshme kanë dhënë edhe profesionistë të fushës, përfaqësues të universiteteve, grupe të ndryshme të interesit dhe shoqëria civile.

Në vazhdim ai u fokusua në përmbajtjen e këtij plani dhe ftoi deputetët për miratim të këtij plani. Fjala e z. Dardan Gashi është dhënë e plotë në transkript.

Më pas, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Planin Hapësinor “Monumenti i natyrës me rëndësi të veçantë - Ujëvarat e Mirushës”.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nait Hasani - në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor; Ramiz Lladrovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Afërdita Berisha-Shaqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Nijazi Idrizi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Sevdije Lama - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Planin Hapësinor “Monumenti i natyrës me rëndësi të veçantë - Ujëvarat e Mirushës”.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 59,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Planin hapësinor monumenti i natyrës me rëndësi të veçantë “Ujëvarat e Mirushës”, me ndryshimet e propozuara nga Komisioni Funkcional.

9. Shqyrtimi i Planit Hapësinor “Zona e mbrojtur me interes të veçantë - Beteja e Koshares”

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Planin hapësinor zona e mbrojtur me interes të veçantë “ Beteja e Koshares”.

Ministri Dardan Gashi tha se “Zona e mbrojtur me interes të veçantë - Beteja e Koshares” paraqet hapësirën në të cilën është zhvilluar Beteja e Koshares nga Brigada 138 “Agim Ramadani”, territori i së cilës shtrihet në komunën e Gjakovës dhe përfshin sipërfaqe prej 2488 hektarë.

Kjo zonë gjendet në pjesën perëndimore të vendit dhe shtrihet përgjatë vijës kufitare me Shqipërinë, në gjatësi prej 22 km.

Kjo zonë gjithashtu ka edhe vlera tjera të trashëgimisë kulturore, të peizazhit, të larmisë biologjike dhe të resurseve të trashëgimisë natyrore.

Në vazhdim ai u fokusua në përmbajtjen e këtij plani dhe ftoi deputetët për miratim të këtij plani. Fjala e z. Dardan Gashi është dhënë i plotë në transkript.

Më pas, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Planin Hapësinor “Zona e mbrojtur me interes të veçantë - Beteja e Koshares”.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nait Hasani - në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor; Ramiz Lladrovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Salih Morina - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Nijazi Idrizi - në emër të Grupit

Parlamentar të AAK-së; Sevdije Lama - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Shaip Muja dhe Time Kadrijaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Planin hapësinor zona e mbrojtur me interes të veçantë “ Beteja e Koshares”.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Planin hapësinor “Zona e mbrojtur me interes të veçantë - Beteja e Koshares”, me ndryshimet e propozuara nga Komisioni Funkcional.

10. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për hartimin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për hartimin e Planit hapësinor të Parkut Kombëtar “ Bjeshkët e Nemuna”.

Ministri Dardan Gashi, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për hartimin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Fjala e z. Dardan Gashi është dhënë i plotë në transkript.

Më pas, kryesuesi e hapi debatin lidhur me propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për hartimin e Planit hapësinor të Parkut Kombëtar “ Bjeshkët e Nemuna”.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nait Hasani - në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor; Ramiz Lladrovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Afërdita Berisha-Shaqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Nijazi Idrizi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Sevdije Lama - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe ministri Dardan Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për hartimin e Planit hapësinor të Parkut Kombëtar “ Bjeshkët e Nemuna”.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 60,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për hartimin e Planit hapësinor të Parkut Kombëtar “ Bjeshkët e Nemuna”.

11. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare

Kryesuesi i njoftoi deputetët për Raportin me rekomandimet të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare.

Deputeti Albin Kurti, në emër të Komisionit Funkcional për Punë të Jashtme e paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve raportin me rekomandime lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare.

Diskutimi i deputetit Albin Kurti është dhënë i plotë ne transkript.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit të lartpërmendur.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe ministri Enver Hoxhaj, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim raportin me rekomandime të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 52,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 9.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Raportin me rekomandime të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare.

* * *

Më pas, Kryesuesi, konstatoi se Kuvendi përfundoi punimet për ditën e sotme, ndërsa për vazhdimin e punimeve të kësaj mbledhje plenare do të vendosë Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e radhës, me kryetarët e grupeve parlamentare.

* * *

Kryesuesi i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 15:50 minuta.

* * *

19 mars 2014, ora 10:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 13 mars dhe e vazhduar më 14 mars 2014

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 13 mars dhe e vazhduar më 14 mars 2014.

* * *

Para se të procedojë me pikat e rendit të ditës, kryetari njoftoi Kuvendin se lidhur me rendin e ditës, për fjalë është paraqitur deputetja Jelena Bontiq.

Jelena Bontiq, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, propozoi që në rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare të hyjë pika - **Shqyrtimi i vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.Ref. A.GJ. 75/10, rasti Nr. KI 08/09.**

Lidhur me propozimin e lartpërmendur kryetari kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare.

Më pas, për këtë çështje u deklaruan deputetët: Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Daut Haradinaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sasha Milosavljeviq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, Duda Balje - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe kryeministri Hashim Thaçi dhe ministri Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim propozimin që pika - Shqyrtimi i vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr.Ref. Agj 75/10, rasti Nr. KI 08/09, të hyjë si pikë e rendit të ditës për mbledhjen e sotme.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin që pika - Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr.Ref. Agj 75/10, rasti Nr. KI 08/09, të hyjë si pikë e rendit të ditës për mbledhjen e sotme.

Kryetari konstatoi se pika e lartpërmendur radhitet si pikë e fundit për shqyrtim në mbledhjen e sotme.

Në vazhdim kryetari procedoi me pikat si në vijim:

12. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryetari në fillim të shqyrtimit të kësaj pike sqaroi në detaje procedurën që nga propozimi i Qeverisë deri te rekomandimet e Organit Përzgjedhës të Pavarur, për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 3 mars 2014, ka shqyrtuar shkresën e dytë të Organit Përzgjedhës të Pavarur dhe me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare ka vendosur që Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit të radhitet për shqyrtim në seancë plenare, tha kryetari.

Fjala e kryetarit është dhënë e plotë në transkript.

Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati deputetë të interesuar për diskutim.

Kryetari hodhi në votim miratimin e Propozim-vendimin për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 43,
Kundër----- 29,
Abstenime----- 8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

I. Anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit të Publik të Kosovës, emërohen:

1. Hysni Hoxha, emërohet kryetar
2. Ekrem Salihu-anëtar,
3. Tefik Sylejmani-anëtar,
4. Vjollca Kurtishaj-anëtare,
5. Bajram Zogiani, anëtar.

II. Mandati i të emëruarve në pikën I. të këtij vendimi është pesë (5) vjet.

13. Zgjedhja e Avokatit të Popullit

Kryetari i informoi deputetët se Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit dhe me Rregulloren për Zgjedhjen dhe Shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të Avokatit të Popullit, ka shqyrtuar propozimin e Panelit rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit dhe rekomandimin me emrat e tre (3) kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit, të renditur sipas alfabetit të mbiemrit, i ka proceduar për mbledhjen plenare.

Arsyetimin e Raportit me rekomandime në emër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, e paraqiti deputetja Suzan Novobërdaliu.

Kryetari, më pas konstatoi se Kuvendi zgjedh Avokatin e Popullit me votim të fshehtë dhe me shumicën e votave të deputeteve të Kuvendit të Kosovës, me së paku 61 vota “për”, për një mandat pesë vjeçar, pa të drejtë rizgjedhje.

Më tej, kryetari sqaroi se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të administratës, dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që të propozojnë nga një anëtarë për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK - Xhevahire Izmaaku,
2. GP LDK - Xhafer Tahiri,
3. GP “Vetëvendosje” - Albana Gashi,
4. GP AAK - Kymete Bajraktari,
5. GP - Koalicioni Kosova e Re - Suzan Novobërdaliu,
6. GP – SLS - Mursel Halilji,
7. GP- “6+” - Fikrim Damka.

Kuvendi miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Rundi i parë i votimit:

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti, Suzan Novobërdaliu.

Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 92 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 2 fletëvotime. Rezultati i votimit ishte si në vijim:

1. Adrijana Hoxhiq i ka fituar 17 vota,
2. Hilmi Jashari i ka fituar 42 vota,
3. Gjyljeta Mushkolaj i ka fituar 31 vota.

Ajo konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit, në rundin e dytë do të hyjnë në votim kandidatët Hilmi Jashari dhe Gjyljeta Mushkolaj.

Rundi i dytë i votimit:

Pas numërimit të fletëvotimeve në rundin e dytë, në emër të Komisionit votues, Raportin e paraqiti, Suzan Novobërdaliu.

Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 91 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 3 fletëvotime. Rezultati i votimit ishte si në vijim:

1. Hilmi Jashari i ka fituar 49 vota,
2. Gjyljeta Mushkolaj i ka fituar 39 vota.

Ajo konstatoi se asnjëri nga kandidatët e lartpërmendur nuk kanë fituar votat e nevojshme për t’u zgjedhur Avokat i Popullit.

Më pas, kryesuesi Sabri Hamiti, konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Asnjëri nga kandidatët e propozuar: Adrijana Hoxhiq, Hilmi Jashari dhe Gjyljeta Mushkolaj, nuk i morën votat e nevojshme për t'u zgjedhur Avokat i Popullit.

2. Konkursi për Avokat të Popullit duhet të përsëritet sipas procedurave të parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit.

14. Zgjedhja e një anëtari joekzekutiv në Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryesuesi konstatoi se meqë janë të propozuar pesë (5) kandidatë për pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, ndërsa me ligj nuk është përcaktuar mënyra dhe forma e përzgjedhjes, votimi do të jetë i fshehtë, ndërsa kandidati duhet të fitojë shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.

Në vazhdim Kuvendi me pëlqimin e të gjitha grupeve parlamentare, miratoi propozimin që nëse asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk do t'i fitonte votat e nevojshme në rundin e parë, atëherë, në rundin e dytë të votimit të hyjnë dy kandidatët me më së shumti vota.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të administratës, tha kryesuesi dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që të propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK - Sala Berisha-Shala,
2. GP LDK - Xhafer Tahiri,
3. GP "Vetëvendosje" - Albana Fetoshi,
4. GP AAK - Teuta Haxhiu,
5. GP - Koalicioni Kosova e Re - Sevdije Lama,
6. GP SLS - Jelena Bontiq,
7. GP- "6+" - Fikrim Damka.

Kuvendi miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

.Në vazhdim deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Rundi i parë i votimit:

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, Raportin e paraqiti Teuta Haxhiu.

Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 93 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 5 fletëvotime. Rezultati i votimit është si në vijim:

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Sejdi Rexhepi, ka fituar 6 vota,

Ramë Rexha, ka fituar 41 vota,

Nuhi Ahmeti, ka fituar 22 vota,

Agim Vishi, ka fituar 7 vota,

Milaim Berisha, ka fituar 12 vota.

Ajo konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit, në rundin e dytë do të hyjnë në votim kandidatët Ramë Rexha dhe Nuhi Ahmeti.

Rundi i dytë i votimit:

Pas numërimit të fletëvotimeve në rundin e dytë, në emër të Komisionit votues, Raportin e paraqiti Teuta Haxhiu. Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 90 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 8 fletëvotime.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Ramë Rexha, ka fituar 42 vota, ndërsa
Nuhi Ahmeti, ka fituar 40 vota.

Teuta Haxhiu, konstatoi se asnjëri nga kandidatët e lartpërmendur, nuk kanë marrë votat e mjaftueshme për t'u zgjedhur anëtar joekzekutiv i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Më pas kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M .

1. Asnjëri nga kandidatët e propozuar për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës: Sejdi Rexhepi, Ramë Rexha, Nuhi Ahmeti, Agim Vishi dhe Milaim Berisha, nuk i morën votat e nevojshme për t'u emëruar anëtar joekzekutiv i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. Konkursi publik për zgjedhjen e një (1) kandidati për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, duhet të përsëritet, në pajtim me nenin 38.2. të Ligjit nr. 03/L- 209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

15. Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media

Kryetari i informoi deputetët se Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media, dhe Kuvendit i ka paraqitur Rekomandimin për miratim.

Arsyetimin e Raportit me rekomandime në emër të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, e paraqiti deputetja Xhevahire Izmaqi.

Ajo tha se sot Kuvendi duhet të bëjë emërimin e pesë (5) anëtarëve, me shumicën e votave të deputetëve që janë të pranishëm dhe që votojnë, me votim të fshehtë, si në vijim:

1. Nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, Kuvendi duhet të zgjedh tre (3) anëtarë, nga gjashtë (6) kandidatë të propozuar,
2. Nga radhët e komunitetit serb, Kuvendi duhet të zgjedh një (1) anëtar, nga dy (2) kandidatë të propozuar,
3. Nga radhët e komuniteteve tjera, Kuvendi duhet të zgjedhë një (1) anëtar, nga dy (2) kandidatë të propozuar.

Më tej, kryetari sqaroi se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të administratës, dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që të propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK - Justina Shiroka- Pula
2. GP LDK - Salih Morina,
3. GP “Vetëvendosje” - Afrim Hoti,
4. GP AAK - Xhevdet Neziraj,
5. GP - Koalicioni Kosova e Re - Suzan Novobërdaliu,
6. GP SLS - Jelena Bontiq,
7. GP “6+” - Rasim Demiri.

Kuvendi e miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Rundi i parë i votimit:

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Salih Morina. Ai konstatoi se në votim morën pjesë 73 deputetë. Rezultati i votimit ishte si në vijim:

I. Nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar:

1. Adnan Merovci, ka fituar 43 vota,
2. Driton Qeriqi, ka fituar 49 vota,
3. Anita Morina, ka fituar 29 vota,
4. Agim Sopi, ka fituar 23 vota,
5. Lumturije Blakaj, ka fituar 24 vota,
6. Naim Maloku, ka fituar 20 vota.

II. Nga radhët e komunitetit serb:

1. Milosh Aritonoviq, ka fituar 30 vota,
2. Milena Gjeric, ka fituar 25 vota.

III. Nga radhët e komuniteteve tjera:

1. Mejdin Saliji, ka fituar 31 vota,

2. Nijazi Ismail, ka fituar 32vota

Ai konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, Driton Qeriqi dhe Adnan Merovci, zgjedhën anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media.

Ndërsa, në rundin e dytë të votimit, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, hyjnë kandidatët Anita Morina dhe Lumturije Blakaj.

Ai më tej theksoi se asnjëri nga kandidatët nga radhët e komunitetit serb dhe nga radhët e komuniteteve tjera, nuk i fituan votat e nevojshme për t'u zgjedhur anëtar i Komisionit të Pavarur për Media, andaj konkursi duhet të përsëritet.

Rundi i dytë i votimit:

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Justina Shiroka-Pula.

Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 66 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 7 fletëvotime.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

I. Nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar:

1. Anita Morina, ka fituar 34 vota,
2. Lumturije Blakaj, ka fituar 25 vota.

Ajo konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit në rundin e dytë, për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, Anita Morina, zgjedhet anëtare e Komisionit të Pavarur për Media.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media nga Komuniteti shumicë shqiptar, emërohen:

1. Adnan Merovci, me mandat katër (4) vjeçar,
2. Driton Qeriqi, me mandat tre (3) vjeçar,
3. Anita Morina, me mandat dy (2) vjeçar.

II. Kandidatët e propozuar për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media, nga radhët e komuniteteve joshumicë nuk i morën votat e nevojshme për t'u zgjedhur anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media.

III. Komisioni i Pavarur për Media duhet të nxjerrë shpallje publike për zgjedhjen e anëtarëve nga radhët e komuniteteve joshumicë, në pajtim me nenin 11. të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

16. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media

Kryetari kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal me ngritje dore të votojnë propozimin e grupeve parlamentare për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Komisionit të Pavarur për Media.

Kuvendi me shumicë votash miratoi formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Komisionit të Pavarur për Media.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Komisionit të Pavarur për Media, në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaku, nga GP i PDK-së, kryesuese,
2. Sadri Ferati, nga GP i LDK-së, zv/kryesues i parë,
3. Albert Kinolli, nga GP i “6+”, zv/kryesues i dytë,
4. Ramë Vataj, nga GP i PDK-së, anëtar,
5. Salih Morina, nga GP i LDK-së, anëtar,
6. Albulena Haxhiu, nga GP i Lëvizjes “Vetëvendosje”, anëtare,
7. Teuta Haxhiu, nga GP i AAK-së, anëtare,
8. Suzan Novobërdaliu, nga GP Koalicioni për Kosovë të Re, anëtare,
9. Jelena Bontiq nga GP i SLS-së, anëtare.

II. Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Komisionit të Pavarur për Media që të veprojë në përputhje me nenin 11, paragrafi të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

17. Shqyrtimi i vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.Ref. AGJ 75/10, rasti Nr. KI 08/09

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.Ref. AGJ 75/10, rasti Nr. KI 08/09.

Kryeministri Hashim Thaçi paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve të Kuvendit Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.Ref. Agj 75/10, rasti Nr. KI 08/09.

Ai ftoi deputetët për miratimin e këtij propozim-vendimi.

Fjala e z. Hashim Thaçi është dhënë e plotë në transkript.

Më pas, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.Ref. Agj 75/10, rasti Nr. KI 08/09.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Donika Kadaj-Bujupi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe kryeministri Hashim Thaçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.Ref. Agj 75/10, rasti Nr. KI 08/09.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 58,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

lidhur me ekzekutimin e aktgjykimit Gjykatës Kushtetuese, datë 17 dhjetor 2010, Nr.Ref. AGJ 75/10, rasti nr. KI 08/09

1. Obligohet Agjencia Kosovare e Privatizimit, që të sigurojë pagesën e borxhit ndaj punëtorëve të Fabrikës për prodhimin e gypave të çelikut në Ferizaj.
2. Qeveria e Republikës së Kosovë, në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka do t'i kryejë të gjitha obligimet që dalin nga aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, datë 17 dhjetor 2010, Nr.Ref. AGJ 75/10, rasti nr. KI 08/09.
3. Afatet për realizimin e pagesës janë si në vijim:
 - a) Pjesa e parë e pagesës në nivelin 50% të shumës së përgjithshme, do të ekzekutohet brenda 30 ditëve nga data e nxjerrjes së këtij vendimi.
 - b) Pjesa e dytë e pagesës në nivelin 25% të shumës së përgjithshme, do të ekzekutohet brenda 3 muajve pas ekzekutimit të pjesës së parë të pagesës.
 - c) Pjesa e tretë e pagesës në nivelin 25% të shumës së përgjithshme, do të ekzekutohet brenda 3 muajve pas ekzekutimit të pjesës së dytë të pagesës.

* * *

Kryetari konstatoi se Kuvendi i përfundoi punimet për ditën e sotme dhe mbylli punimet në orën 17:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

*Përgatiti: Selman Ymeri,
Njësia për Mbështetje Kryesisë dhe Seancës Plenare*